



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 130, datë 30.07.2018

PËR

MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 194, pika 4 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Zyrës së Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e subjektit “UJORI” sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.
2. Miratimin e Zj. Danjela Dishani për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të subjektit “UJORI” sh.p.k.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI